

VENDIM
Nr.858, datë 14.12.2011

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT NGA
MINISTRIA E BRENDSHME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË,
MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR DISA SHËRBIME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Brendshme, si organ qendror blerës, të realizojë, brenda datë 31 dhejtor 2011, procedurat e prokurimit, me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti, të përcaktuara bashkëlidhur këtij vendimi. Brenda këtij afati të përfshihen lidhja e kontratave dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritete kontraktore, të përmendura në aneks, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha